




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATE/A:	22.11.2017
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP 03-03/2349/17
PËR/ZA/TO:	z. Berat MARMULLAKU, u.d. Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit – Ministria e Shëndetësisë
CC:	z. Naim BARDIQI, u.d. Sekretar i Përgjithshëm – Ministria e Shëndetësisë
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Zgjerimi i Infrastrukturës për SISH "

I nderuari z. Marmullaku,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin "Zgjerimi i Infrastrukturës për SISH" me numër prokurimi: 206-17-2793-111 dhe me nr. të brendshëm: 206-17-026-111, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin "Zgjerimi i Infrastrukturës për SISH" me numër prokurimi: 206-17-2793-111 dhe me nr. të brendshëm: 206-17-026-111, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

A r s y e t i m i

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia) me datë 06.09.2017, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-2349/17*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull *"Zgjerimi i Infrastrukturës për SISH" me numër prokurimi: 206-17-2793-111 dhe me nr. të brendshëm: 206-17-026-111*, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Ministria e Shëndetësisë.

Agjencia ka hapur këtë rast për trajtim, pas ftesës së datës 06.09.2017, nga ana e Autoritetit kontraktues Ministria e Shëndetësisë, ku me këtë rast përfaqësuesi i autorizuar i Agjencisë ka marr pjesë si monitorues gjatë procedurës rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave.

Agjencia pasi ka marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tenderëve dhe pasi ka analizuar dhe trajtuar dokumentet në dispozicion për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Shkeljet ligjore gjatë përgatitjes së njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit

Në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit Agjencia ka vërejtur se është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar së paku 3 projekte të natyrës dhe kompleksitetit të ngjajshëm. Së paku njeri nga projektet duhet të ketë vlerë prej minimum 1.5 milion EURO, në 3 vitet e fundit (2014, 2015, 2016). Sipas nenit 68 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik, kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës. Në përgjithësi, operatorëve ekonomik u lejohet të plotësojnë këtë kërkesë duke paraqitur, nëse është me rëndësi dhe e nevojshme, një ose më shumë nga referencat e dhëna.

Sipas nenit 69 këtij Ligji, për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale, Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen.

Në paragrafin 2.1. është paraparë që Autoriteti kontraktues mundet të kërkojë listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënen shkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë. Por nuk është e lejuar që Autoriteti kontraktues të kërkojë nga tenderuesit të kenë një referencë të vetme në këtë vlerë të caktuar monetare, por duhet kërkuar vlerën e përgjithshme të të gjitha referencave të realizuara në tri vitet e fundit. Një kërkesë e tillë kufizuese i favorizon vetëm Operatorët ekonomik që kanë referenca në këtë vlerë të caktuar.

Shkeljet ligjore gjatë vlerësimit të tenderëve:

Gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, AKK ka vërejtur se hapja e tenderit është bërë me datë 28.08.2017, ndërsa nënshkrimi i raportit të vlerësimit të tenderëve nga ana e komisionit vlerësues është bërë me dt.31.10.2017, pra procedura e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve nga ana e komisionit vlerësues ka zgjatur 65 ditë. Veprim ky i cili bie ndesh me Legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Bazuar në Rregullat dhe udhëzuesin operativ neni 41.2 " procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga Autoriteti kontraktues **brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.** Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë **prej 20 ditësh.** Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve dhe jo më vonë se 5 dite pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve ".

Veprimet e Autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 68 Gjendja ekonomike/financiare, nenin 69 Aftësia teknike/ profesionale të Ligjit Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 41 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, dhe që të mos përsëriten praktikat e tilla në të ardhmen.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !